

LIGJ
Nr.8348, datë 20.5.1998

PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Akcizat janë tatime mbi një numër të kufizuar mallrash për konsum masiv të brendshëm, pavarësisht nëse prodhohen brenda vendit apo importohen.

Neni 2

Personat fizikë a juridikë vendas dhe të huaj që i nënshtrohen këtij tatimi, janë prodhuesit dhe importuesit e mallrave të tatueshme me akcizë.

Neni 3

Mallrat e veçanta që taten me akcizë, përqindjet e tyre dhe vlera e akcizës për pullë janë

	Përqindja e akcizës	Vlera e akcizës për një pullë
A.Duhan e prodhime duhani		
- Duhan për konsum		
- vendi	70	
- importi	105	
- Cigare		
Kategoria I		
- importi		27 lekë për paketë
- vendi		14 lekë për paketë
Kategoria II		
- importi		15 lekë për paketë
- vendi		8 lekë për paketë
Kategoria III		
- importi		11 lekë për paketë
- vendi		
- blend		7 lekë për paketë
- oriental		14 lekë për paketë
- puro importi		2240 lekë për kilogram
B.Pije alkoolike		
- Birrë		
- vendi	40	
- importi	65	

- Verë		
- vendi		40 lekë për litër
- importi		50 lekë për litër
- Raki		
- vendi		90 lekë për litër
- importi		115 lekë për litër
- Konjak, uzo, fërnë, ponç, uiski rum, likerna dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike		
- vendi		90 lekë për litër
- importi		150 lekë për litër
Pije joalkoolike, freskuese e të tjera		
- vendi	5	
- importi	30	
Ujë mineral dhe i gazuar		
- vendi	-	
- importi	20	
D. Kafe	20	
DH. Nënprodukte të naftës		
- Benzinë deri 75 oktanë vendi	50	
- Benzinë 75.1 - 89.9 oktanë vendi	77	
- Benzinë deri 89.9 oktanë importi	120	
- Benzinë 90 oktanë e lart importi	120	
- Benzinë pa plumb	140	
- Gazoil		
- vendi	30	
- importi	50	
- valvolinë	80	
- Vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe grasot		
- vendi	40	
- importi	80	
- Të tjera (solar, mazut, koks nafte, bitum gaz i lëngët , toluol, squfur, ksilol, solvent)	25	

Importi i çdo lloj nënprodukti nafte që nuk përfshihet në shkronjën "Dh", përveç vajgurit që trajtohet me akcizë, i vendit me 110 për qind dhe i importit me 150 për qind, do të trajtohet me akcizë 300 për qind.

Përfshihen nga akcizat gazi i lëngët i importit për përdorim në popullsi, si dhe mazuti e solari të prodhuar në vend që përdoren për prodhim avulli për ngrohjen e popullsisë.

Neni 4

Llogaritja e akcizës bëhet:

a) për mallrat e prodhuara në vend, në bazë të vlerës së çdo sasi malli të shitur. Për nënproduktet e naftës, në bazë të çmimeve të brendshme të përcaktuara nga organet shtetërore.

b) për mallrat e importuara, në bazë të vlerës doganore.

Neni 5

Akciza derdhet në buxhetin e shtetit:

- a) për mallrat e prodhuara në vend, deri 5 ditë që nga momenti kur prodhuesi lëshon faturën (në vlerën e së cilës shton akcizën dhe mbledh akcizen nga blerësi për llogari të buxhetit të shtetit) për shitje blerësit, me përjashtim të rastit të mallrave, akciza e të cilave paguhet me pullën fiskale;
- b) për mallrat e importuara, deri 5 ditë që nga momenti i pagesës në doganë të detyrimit të akcizës (që bëhet njëherësh me pagimin e taksës doganore), me përjashtim të rastit të mallrave, akciza e të cilave paguhet me pullë fiskale.
- c) për prodhimet, akciza e të cilave paguhet me pullë fiskale, në momentin e blerjes së pullave nga subjektet që kanë bërë kërkesë.

Neni 6

Mallrat e përcaktuara në nenin 3 që do të eksportohen, nuk kanë detyrim për akcizë. Ndalohet aplikimi i pullave fiskale mbi produktet e destinuara për eksport dhe në çdo rast asnjë ribursim nuk jepet në të tilla raste.

Neni 7

Pagimi i akcizës bëhet vetëm një herë nga importuesi ose prodhuesi i mallrave. Çdo shitje e mëtejshme me shumicë e mallrave të tatueshme me akcizë nuk i nënshtrohet pagimit të akcizës.

Neni 8

Prodhuesit e importuesit e mallrave që tatohen me akcizë dhe organet doganore detyrohen të mbajnë llogari të veçantë, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore për akcizat e realizuara e të derdhura brenda datës 10 të muajit pasardhës, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave.

Neni 9

Konsiderohen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja dhe falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e akcizave.
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël për akcizat.
- Dërdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit.
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara.

Neni 10

Shkeljet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, dënohen edhe me këto masa:

- Fshehja dhe falsifikimi i akcizave me gjobë në masën 5 fish të shumës të akcizës së fshehur ose të falsifikuar dhe me marrjen 100 për qind të akcizës së fshehur ose të falsifikuar.
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël, me gjobë nga 5000 deri në 10 000 lekë
- Dërdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit me gjobë 5000 lekë dhe me kamatëvonesë në masën 0.10 për qind për çdo ditë vonese.
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara me gjobë 2000 deri në 6000 lekë.

Neni 11

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të marrin masa për prodhimin e pullave për artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike.

Neni 12

Ligji nr.7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ligji nr.8247, datë 2.10.1997 dhe të gjitha ligjet e tjera, me të cilat janë bërë ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2106, datë 28.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani